



# EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RIKIKLO -

## EKO KLUBI

## "KUJTIM KRASNIQI"

# 2





♦ Të dashur lexues,

EKjo është seria e dytë e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Qendrës së Kompetencës "Kujtim Krasniqi" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.

Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).



## MJEDISI

Mjedisi është elementi thelbësor për jetën tonë dhe për të ardhmen e planetit tonë. Mjedisi është thesari më i çmuar që kemi. Në shekullin 21, kur përparimet teknologjike po rriten me shpejtësi të madhe është thelbësore të kujtojmë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit.

Një nga sfidat kryesore që përballet mjedisi është ndryshimi i klimës. Ndryshimet e temperaturës globale janë pasoja serioze për biodiversitetin, shkëputjen e akullnajave dhe ndotjen e ajrit. Kjo tregon se është koha për veprime të menjëhershme.

Si individ, kemi përgjegjësi të përdorim burimet natyrore me kujdes dhe të reduktojmë ndotjen duke përdorur teknologjitë mjedisore miqësore. Gjithashtu, mbrojtja e pyjeve dhe biodiversiteti janë thelbësore për shëndetin e tokës. Përmes aktiviteteve të qëndrueshme, si mbjellja e pemëve dhe ruajtja e habitateve natyrore, ne mund të ndihmojmë në mbrojtjen e shtjellave të jetës. Si individë, kemi fuqinë të ndryshojmë ambientin duke përdorur energji të rinovueshme, duke recikluar dhe duke përdorur produkte të bëra me kujdes ndaj mjedisit.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë janë po aq të rëndësishme sa veprimet individuale. Duke ndihmuar, të tjerët kuptojnë rëndësinë e mjedisit, ne mund të krijojmë një lëvizje globale për ruajtjen e planetit tonë.

Andaj ruajtja e mjedisit është detyrë e përbashkët që kërkon angazhim dhe veprime të përbashkëta. Bashkë do të punojmë për të krijuar një mjedis më të pastër dhe më të qëndrueshëm për të ardhmen tonë.

# FITUES TË ÇMIMIT MJEDISORE "DERVISH ROZHAJA"

Ky çmim synon të promovojë edukimin mjedisor dhe klimatik të të rinjve në Kosovë, të rritë angazhimin e tyre përmes aktiviteteve konkrete, si dhe të njohë projektet më të mira mjedisore të realizuara nga ta në shkollat e tyre.

Tre fituesit e shpallur për vitin 2023 janë:

- Çmimi i parë (investime në shkollë në vlerë prej 10,000 EUR):  
Eko Klubi nga shkolla e mesme e lartë  
[Qendra e Kompetencës "Kujtim Krasniqi" në Malishevë](#)
- Çmimi i dytë (investime në shkollë në vlerë prej 3,500 EUR):  
Eko Klubi nga shkolla e mesme e lartë  
SH.M.L "DARDANIA" Hani i Elezit
- Çmimi i tretë (investime në shkollë në vlerë prej 1,500 EUR):  
Eko Klubi nga shkolla e mesme e lartë  
Gjimnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri.





**EKO KLUBI "KUJTIM KRASNIQI"**



# AKTIVITETET E EKO-KLUBIT:

## TAKIMI MES EKO-KLUBIT DHE EC MA NDRYSHE





## DOKUMENTAR MJEDISOR ME EKO -KLUBET

Dokumentari mjedisor në "Kino Lumbardh" për 12 Eko - Klubet e Shkollave të Mesme të Rajonit të Jugut (Prizren, Rahovec, Malishevë dhe Mamushë). Ky aktivitet është pasuar me diskutim në mes anëtarëve të eko klubeve mbi çështjet mjedisore të trajtuara në dokumentar.

Gjatë këtij aktiviteti u shqyrtua se si veprimet tona të pakujdesshme ndaj natyrës çojnë drejt degradimit të planetit, ta bëjnë atë të pabanueshëm për miliona njerëz dhe si do të sjellin shkatërrimin e popullatave të biodiversitetit.

Ky aktivitet përveç njohurive të reja dhe aktivizimit të nxënësve për të ofruar zgjidhje të ndryshme mbi këto çështje, po ashtu kontribuoi edhe për shoqërimin e tyre duke ndarë mes vete përvojat për aktivitetet mjedisore që ata realizojnë në shkollat e tyre.





## INAGURIMI I PROJEKTIT MJEDISOR

Eko Klubi “Kujtim Krasniqi” në Malishevë realizoi projektin mjedisor. Me anë të këtij projekti eko klubi ka rritur hapësirën e gjelbër në Qendrën e Kompetencës, duke e shndërruar kështu atë në një zonë rekreative që do të shfrytëzohet nga të gjithë nxënësit.

Në këtë hapësirë janë mbjellur drunjë dhe bimë shumë vjeçare, janë vendosur ulëse dhe shporta për mbeturina.

Anëtarët e eko klubit dhe stafi i shkollës gjatë kësaj periudhe kanë realizuar edhe disa sesione informuese dhe broshura mbi mbrojtjen dhe kujdesin ndaj mjedisit dhe në mënyrë vetanake kanë vendosur edhe sistemin pikë-pikë për të rritur kështu qëndrueshmërinë e këtij investimi.



# **EKO KLUBI "KUJTIM KRASNIQI"**

## **RR. HABIB BERISHA, LAGJJA E MIRËDITËS, MALISHEVË**

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe  
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,  
Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)  
[info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".